



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:234535  
Datë: 07.10.2024  
Numri i dokumentit: 06261740

**C-IV-13-1224**

*Ankuesi*

**B S Kllokot.**

*Kundër*

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 01 tetor 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr. GJI095-0422, datë 21 maj 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 09 korrik 2013, ankuesi (nëpërmjet postës) dorëzoi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (më tej: Dhoma e Posaçme), një ankesë kundër Vendimit nr. GJI095-0422, datë 21 maj 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin i ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim për paga të papaguara për periudhën qershor 1999 – prill 2010 në shumë prej 46,956.00 € nga NSH “Banja e Kllokotit” në (në likuidim). Ankuesi pohoi se ka qenë në marrëdhënie pune për shumë vite në NSH “Banja e Kllokotit” i sistemuar në vendin e punës shërbyes (kamarier), të cilit në vitin 1999 iu ka ndërprerë marrëdhënia e punës. Ankuesi më tej pohon se sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, si punëtor pranë NSH-së, ai ka të drejtë në pjesën e 20 % nga çmimi i shitjes dhe se ka prova se është punëtor i evidentuar në këtë kompani. Ankuesi më tej shton se edhe pse ligji e parasheh se tri vitet e fundit puëntori duhet të jetë në marrëdhënie pune para privatizimit, ai nuk ka mundur të vijoj punën për shkak të rrethanave të pasluftës, në ndërkohë nga ana e shërbimit përkatës është hartuar lista e punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën e pjesëmarrjes në 20 %, me rastin e përpilimit të listës për arsye të pabaza nuk është përfshirë emri im në listën përfundimtare të 20 %. Nga dëshmitë të cilat gjenden në dosjen e tij pranë ndërmarrjes, pa mëdyshje rezulton se një e drejtë e tillë i takon

edhe atij sipas vendimit për caktimin e vendit dhe detyrave të punës nga NSH “Banja e Klllokotit”. Si përfundim, shpreson se do të mundësohet realizimi i kësaj të drejte. Në mbështetje të ankesës së tij ankuesi dorëzoi vendimin e kundërshtuar dhe dëshmitë në kopje si: librezën e tij të punës dhe letërnjoftimin.

Me 30 janar 2024, e paditura AKP parashtroi mbrojtjen e saj në të cilën pohoi se i përmbahet qëndrimit se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme ligjore gjithashtu janë zbatuar saktësisht. E paditura konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e vendimit të AL. Në këtë kontekst, neni 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJSK kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 74.2 i Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJSK kundër vendimeve të AL duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për AKP-në. Prandaj, në pajtim me qëndrimin e vet parashtruesit, vendimi nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit 04/L-034 dhe prandaj nuk ka bazë ligjore për të shfuqizuar vendimin. Rrjedhimisht, në zbatim të nenit 74.2 të Ligjit 06/L-086 ankesa në fjalë është e pabazuar. Gjithashtu parashtruesi ka dështuar të ofroj ndonjë argument ligjor në mbështetje të ankesës së tij dhe në këtë mënyrë ka shkelur nenin 35.2.4 të Ligjit nr. 06/L-086, i cili parashikon që një *“ankesë duhet të përmbaj [...] argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet ankesa”*. E paditura më tej thekson se pretendimet e ankuesit janë të parashkruara në pajtim me nenet 36.2.1 dhe 37.4.1 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 dhe nenit 608 të Ligjit për Punën e Bashkuar (LPB). Ankuesi thekson se kërkon paga deri në privatizim, prandaj në përputhje me dispozitat ligjore të mësipërme, kërkesa konsiderohet e parashkruar tre vjet pas kësaj date. E paditura më tej shton se në përputhje me qëndrimin e vet parashtruesit, është e pakontestueshme se ai nuk ka punuar për NSH-në nga viti 1999. Për më tepër, parashtruesi thekson se ka braktisur vendin e punës që nga viti 1999 dhe këtu në ankesë kërkon kompensimin e pagave që nuk i ka realizuar gjatë kësaj periudhe, pra nga viti 1999 deri në hyrjen e NSH-së në likuidim. Si rrjedhojë pretendimet e tij për t’u kompensuar për një periudhë kohe që nuk ka ofruar shërbime pune janë tërësisht të pabazuara. Marrëdhënia e punës karakterizohet nga ofrimi i shërbimeve të punës kundrejt kompensimit monetar, që në këtë rast parashtruesi nuk ka ofruar asnjë shërbim pune për NSH-në. Sa i përket pretendimit se ankuesi është diskriminuar, AKP mban qëndrimin se ky pretendim është plotësisht i pabazuar për arsye se parashkrimi i kërkesës për kompensim të pagave të papaguara në përputhje me nenin 608 të LPB (GZ 53/1976) ishte zbatuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të drejtë ndaj të gjitha kërkesave të punëtorëve të NSH tek cilido AL, pa marr parasysh përkatësinë etnike, moshën apo gjininë. E paditura thekson se fakti se parashtruesi është i përfshirë në listën e 20 % tregon se parashtruesi është thjesht në regjistrat e NSH-së dhe jo se ka ndërprerë afatin e parashkrimit të kërkesës. E drejta për “20%” paraqet një të drejtë shumë specifike të rregulluar me kritere/dispozita specifike (neni 10 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13) dhe nuk cenon në asnjë mënyrë të drejtën e parashtruesit për të kërkuar paga të papaguara. Sa i përket, pretendimeve për diskriminim e paditura shton se procedurat ligjore në lidhje me “kërkesa të bazuara në diskriminim” rregullohen me akte të ndryshme ligjore dhe si të tilla janë të papranueshme për sa i përket këtij procesi. Së fundmi, pa

paragjykuar qëndrimin e sipërpërmendur AKP kundërshton ekzistencën dhe shumën e kërkesës, e cila nuk bazohet në asnjë provë apo përllogaritje të saktë, por vetëm në shuma arbitrare të dhëna nga parashtruesi. Si përfundim, e paditura i propozon gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar si dhe të vërtetoj vendimin e AL në pajtim me Nenin 74.4 të Ligjit Nr.06/L-086.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligji.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Ankuesi nuk kishte parashtruar prova relevante në procedurën e likuidimit tek AL, as në kohën e parashtrimit të ankesës në gjykatë kundër vendimit të AL nr. GJI095-0422, datë 21 maj 2013, me të cilat do të mund të dëshmonte se ka ofruar shërbime / punë për NSH dhe se NSH detyrohet për kompensimin e pagave të pretenduara si të papaguara, për periudhën kohore qershor 1999 – prill 2010 në shumë prej 46,956.00 € nga NSH “Banja e Kllokotit” (*në likuidim*). Ankuesi vetëm ka përcaktuar periudhën kohore për të cilën kërkon pagat e papaguara, por nuk ka ofruar asnjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe as llogaritjen e pagave të kërkuara. Pra, nuk është dorëzuar asnjë dëshmi për të mbështetur pretendimet e ankuesit në lidhje me kërkesën e tij për paga të papaguara sipas vendimit të kundërshtuar. Për më tepër, ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij edhe pas mbrojtjes së të paditurës për përgjigje.

Si përfundim, gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara për periudhën kohore qershor 1999 – prill 2010 në shumë prej 46,956.00 € nga NSH “Banja e Klllokotit” (*në likuidim*), nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Gjykata ka shqyrtuar me kujdes edhe pretendimet e tjera të ankuesit rreth diskriminimit, por gjen se të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe përveç lënies në fuqi të vendimit të kundërshtuar me të cilin ishte refuzuar kërkesa e tij për paga të papaguara për periudhën objekt kontesti, prandaj si të tilla edhe refuzohen. Fakti i përfshirjes ose jo në listën për përfitim nga 20 % i të ardhurave të shitjes së NSH-së pavarësisht kriterëve sipas të cilave është përfshirë në atë listë, nuk mund të shërbej si bazë për të kërkuar kompensim për paga të papaguara për periudhën objekt kontesti, pasi siç edhe u arsyetua më lartë, nuk ka prova apo dëshmi se i njëjti ka ofruar shërbime apo punë për NSH për periudhën në fjalë. Pra procedura për shqyrtimin e ankesave ndaj Listës Përfundimtare të Punëtorëve me të drejta legjitime për të marr pjesë në 20 % të të ardhurave nga privatizimi i ndërmarrjes nuk ka ndonjë efekt tjetër përveç të drejtave për të marr pjesë në 20 % nga shitja apo privatizimi i NSH-së. Në këtë kuptim edhe pretendimet ankimore për përfshirje në listën e 20 %, refuzohen pasi siç dihet ekziston një procedurë e veçantë e shqyrtimit të atyre kërkesave andaj si të tilla janë jashtë objektit të shqyrtimit të vendimit të kundërshtuar.

Gjykata ka shqyrtuar me kujdes edhe pretendimet e tjera të palëve në lidhje me objektin e kontestit, por gjen se të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe në këtë çështje.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli  
Gjyqtar